



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4329/1 Prot.

Tiranë, më 8 . 7 . 2025

URDHËR

NR. 317, DATË 8.7.2025

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR
NGA "ADMINISTRIM BIZNESI" NË "ADMINISTRIM BIZNESI, ME PROFILE" NË
KOLEGJIN UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË" (CIT).**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe shkronjës "g", të pikës 2, të urdhrin nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë nga "Bachelor" në "Administrim Biznesi" në "Bachelor" në "Administrim Biznesi" me profile: "Marketing Digjital" dhe "Analizë e Biznesit" në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" (CIT), me 180 kredite dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë me kod 63BA0413A.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë "Bachelor" në "Administrim Biznesi" me profile, në Fakultetin e Ekonomisë në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", referuar nivelit 6, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar të studimit të ciklit të parë "Administrim Biznesi" me profile, në Fakultetin e Ekonomisë në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" (CIT), fillon sipas legjislacionit në fuqi.
3. Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"(CIT), të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT), të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT) .

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ

